

Berat Xhimshiti debuton ne Seria A

nga Administrator
E martë, 03 Maj 2016 10:25



Mbrojtësi i kombetares shqiptare Berat Xhimshiti ka debutuar ne Seria A italiane. Ai eshte aktivizuar per 90 minuta ne humbjen qe skuadra e tij Atalanta ka bere ne San Paolo te Napolit. Atalanta ka humbur me rezultatin 2-1 perball ekipit te mbrojtësit shkodran te Napolit Elsaed Hysaj. Xhimshiti u transferua nga Zurich tek Atalanta ne muajin janar dhe tani pasi Atalanta ka siguruar qenrimin ne Seria A i ka dhene mundesine mbrojtësit shqiptar te tregojë kualitetet e tij. Mbrojtësi 23-vjeçari nuk e ka nisur mire takimin por me kalimin e minutave ambjentohet dhe zhvillon nje ndeshje pozitive. Shpesh here eshte i sakte ne nderhyrjet e tij kunder goleshënuesit te Seria A, Higuain.

Per skuadren e Napolit eshte aktivizuar per 90 minuta edhe Hysaj. Ai ka zhvilluar nje ndeshje pozitive duke konfirmuar momentin e mire qe po kalon.